



Direktiva për persona plotësisht të vaksinuar kundër COVID-19

DATA: 16 mars 2021

ORGANIZATA: Departamenti i Shëndetit Publik

BURIMET E REFERUARA: [Rekomandime të përkohshme të shëndetit publik nga CDC-ja, për persona plotësisht të vaksinuar](#)

Vaksinat kundër COVID-19 aktualisht të autorizuara në Shtetet e Bashkuara, janë shumë të efektshme për të mbrojtur personat e vaksinuar kundër formave të rënda të COVID-19. Derisa të vaksinohen më shumë persona, disa masa parandaluese do të vazhdojnë të jenë të nevojshme për të gjithë, edhe për ata që janë vaksinuar plotësisht. Këto direktiva bazohen në [Rekomandimet e CDC](#) për persona plotësisht të vaksinuar.

Çfarë do të thotë të jesh vaksinuar plotësisht

- Një person konsiderohet si i vaksinuar plotësisht kundër COVID-19 në qoftë se ka marrë dy doza të vaksinës Moderna ose Pfizer kundër COVID-19 ose një dozë të vetme të vaksinës Janssen (Johnson & Johnson) më shumë se 14 ditë më parë.
- Këto udhëzime nuk vlejnë për persona plotësisht të vaksinuar, që kanë simptoma të COVID-19.

Grumbullimet me persona të tjerë

1. Vazhdoni të mbani maskë dhe të shmangni kontaktin e ngushtë me të tjerët në publik.

Vaksinimi kundër COVID-19 do të ndihmojë për t'ju mbrojtur nga COVID-19, por ekspertët ende po kryejnë studime për të kuptuar nëse vaksinat gjithashtu pengojnë që personat e vaksinuar të përhapin COVID-19. Mbajtja e maskës dhe distancimi social ndihmojnë për të ulur shanset që t'ua kaloni virusin të tjerëve. Së bashku, vaksinimi kundër COVID-19 dhe ndjekja e rekomandimeve të CDC [për të mbrojtur veten dhe të tjerët](#) do të ofrojnë mbrojtjen optimale ndaj infektimit me COVID-19 dhe përhapjes së infektimit.

2. Mund të shkoni për vizitë te persona që janë vaksinuar plotësisht.

Mund të shkoni për vizitë te persona të tjerë të vaksinuar plotësisht, në mjedise të brendshme private, pa mbajtur maskë dhe pa respektuar distancimin fizik. Për shembull, nëse jeni

vaksinuar plotësisht, rreziku për ju është i ulët, po të ftoni miq plotësisht të vaksinuar për darkë në shtëpinë tuaj.

3. Bëni kujdes kur takoheni me persona që nuk janë vaksinuar.

Departamenti i Shëndetit Publik i Massachusetts-it rekomandon të ndiqni atë direktivë të CDC-së, e cila thotë se mund të shkoni për vizitë, pa mbajtur maskë dhe pa ruajtur distancimin fizik, në një mjedis të brendshëm privat, te persona të pavaksinuar nga një familje e vetme, që nuk janë të rrezikuar nga [infektimi i rëndë me COVID-19](#). Për shembull, gjyshërit e vaksinuar plotësisht mund të rrinë, në mjedise të brendshme, me bijtë e tyre të pavaksinuar dhe nipat e tyre të shëndetshëm, pa mbajtur maskë dhe pa ruajtur distancimin fizik, me kusht që asnjë nga pjesëtarët e pavaksinuar të familjes nuk janë në rrezik për t'u sëmurur rëndë me COVID-19.

Në qoftë se personat e pavaksinuar vijnë nga disa familje OSE kanë rrezik të shtuar për infektim të rëndë me COVID-19, të gjithë duhet të bëjnë kujdes dhe të mbajnë një maskë të puthitur mirë, të ruajnë një distancë prej së paku 1.8 m nga njëri-tjetri dhe të takohen në mjedise të hapura ose të ajruara mirë. Për shembull, në qoftë se një person i vaksinuar plotësisht shkon për vizitë te një mik i pavaksinuar që është shtatëdhjetë vjeç dhe prandaj i rrezikuar për t'u sëmurur rëndë, takimi i tyre duhet të ndodhë përjashta dhe të gjithë duhet të mbajnë maska të puthitura mirë dhe të ruajnë distancën fizike (së paku 1.8 m) nga njëri-tjetri.

4. Ndiqni direktivat shtetërore për pjesëmarrjen në grumbullime të mëdha, si në dasma dhe koncerte.

Të gjithë, edhe ata që janë vaksinuar plotësisht, duhet të ndjekin direktivën e tanishme për kufizimin e grumbullimeve, si dhe rregullat e sigurisë sektor-specifike për aktivitete të tilla si koncertet. Njihuni me urdhëresat më të fundit për [Kufizimet e grumbullimeve](#).

Izolimi, karantina dhe testimi

1. Nuk ka nevojë të ndiqni Udhëzimin e Massachusetts-it për Udhëtimet.

Udhëzimi që gjithë vizitorët që hyjnë në Massachusetts, përfshi rezidentët që kthehen në shtëpitë e tyre, duhet të mbajnë karantinë për 10 ditë pas mbërritjes nuk vlen për ata që janë vaksinuar plotësisht.

2. Rrini në shtëpi dhe testohuni, në qoftë se nuk ndiheni mirë.

Edhe pse vaksinat janë tejet efektive, ka gjithnjë një shans që ta merrni COVID-19, edhe pasi të vaksinoheni. Nëse zhvillon simptoma të rrugëve të frymëmarrjes, si rrufë, kollë ose humbje të shqisës së nuhatjes ose të shijes, këto nuk janë efekte anësore të vaksinës dhe duhet të konsideroni që të testoheni për COVID-19 ose të flisni me ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor. Rrini në shtëpi po të jeni sëmurë dhe shmangni kontaktin e afërt me të tjerët. Mund t'ju duhet të pyesni punëdhënësin tuaj, se si do të ndikojë kjo në marrëdhëniet tuaja të punës.

3. Izolohuni, po të testoheni pozitiv për COVID-19.

Po të testoheni pozitiv për COVID-19, duhet të izoloheni. Vaksinat kundër COVID-19 nuk do të bëjnë që [testi juaj viral](#) të dalë pozitiv.

4. Kontrollohuni për simptoma, nëse jeni në kontakt të ngushtë me dikë të infektuar me COVID-19.

Në qoftë se nuk jetoni dhe as punoni në një mjedis kolektiv (p.sh. në institucione korrektimi dhe burgje, qendra të jetesës së asistuar, azile pleqsh dhe banesa kolektive), nuk keni nevojë të hyni në karantinë pas një ekspozimi. Megjithatë, duhet të bëni kujdes për simptoma të COVID-19 për 14 ditë pas ekspozimit. Po të përjetoni simptoma, izolohuni nga të tjerët dhe lidhuni me ofruesin e kujdesit shëndetësor, ose testohuni.

SHËNIM: Kërkesat për personelin e kujdesit shëndetësor mund të ndryshojnë nga sa më lart. Shihni [Direktivën për kthimin në punë pas COVID-19](#) për më shumë informacion.